





REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

KRYETARI I KOMUNËS  
MUNICIPAL PRESIDENT  
PRESDENNIK OPSTINE

Tel / Fax: 038/200-46002  
Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.  
E-mail: [info.ferizaj@rks-gov.net](mailto:info.ferizaj@rks-gov.net)

DATA/DATUM/DATE	27.01.2023
NR/BR.	01-Nr. 44/23
PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës së Ferizajt
PËRMES/PREKO/THROUGH	Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës 
NGA/OD/FROM	Agim Alin, Kryetar i Komunës së Ferizajt 
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim - Vendim për plotësim ndryshimin- Rishqyrtimin e Vendimit Nr. 01. Nr. 148 të daës 30.11.2022 për taksa komunale

Në bazë të nenit 58 pika h të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kryetari i Komunës përmes Komitetit për Politikë dhe Financa i propozon Kuvendit të Komunës të marrë:

#### VENDIM

- Për;
1. Plotësim ndryshimin - rishqyrtimin e Vendimit Nr. 01. Nr. 148 të daës 30.11.2022 përmes së cilit është miratuar Rregullorja për Taksa Komunale.
  2. Plotësohet - Ndryshohet si në vijim Rregullorja për Taksa Komunale;

#### Neni 1 Qëllimi i rregullores për taksa dhe tarifa komunale riformulohet si në vijim;

- Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e aktiviteteve të cilat i nënshtrohen taksës komunale në Komunën e Ferizajt (këtu e tutje "Komuna"), lartësinë e taksave komunale dhe përcaktimin e kategorive të liruara nga kjo taksë. - Largohet nga rregullorja pjesa për sa i përket përcaktimit të kundërvajtjeve dhe sanksioneve kundërvajtëse për shkeljet e dispozitave të kësaj Rregulloreje.

### **Neni 17 Taksat për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve të gjendjes civile;**

Ndryshohet për sa ju përket taksave në nënit 7 pika 13, 14, 16, 17 dhe 18 si në vijim;

17.13 Regjistrimet e mëvonshme të të lindurve në institucionet shëndetësore që kanë kaluar afatin ligjor 30/tridhjetë ditë)	20-50 €
17.14 Regjistrimet e mëvonshme e të të lindurve jashtë institucioneve shëndetësore brenda territorit të R. së Kosovës që kanë kaluar moshën 12 vjeçare	20-50 €
17.16 Regjistrimi i mëvonshëm i lindjes për persona të cilët nuk mund të ofrojnë asnjë dëshmi	20-50 €
17.17 Regjistrimet e mëvonshme të vdekjes në institucionet shëndetësore brenda territorit të R. së Kosovës	50-100 €
17.18 Regjistrimet e mëvonshme të vdekjes jashtë institucioneve shëndetësore brenda territorit të R. së Kosovës.	50-100 €

### **Neni 26 Tarifat dhe ngarkesat e përgjithshme, plotësohet me pjesën e udhëzimit administrativ;**

Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 05/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MAE) Nr. 09/2020 për Tarifat e Shërbimeve për Regjistrimin e të Drejtave e Pronës së Paluajtshme.

### **Neni 27 Taksat për leje ndërtimi, rrënimi, dhe rritje të densitetit**

27.1 Taksat/tarifat komunale sipas kësaj rregulloreje janë përcaktuar, sipas shërbimeve që do ti marrin të gjithë personat fizik dhe juridik, që operojnë në territorin e komunës së Ferizajt.

27.2. Taksat/tarifat nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit, do të aplikohen sipas shërbimeve të kryera, lejeve të lëshuara etj. sipas tabelave të poshtëshënuara.

27.3. Taksat/tarifat për pajisje me leje ndërtimore (ndërtim të lartë dhe individual), llogaritet sipas projektit zbatues që ofrojnë personat fizik dhe juridik dhe llogaritet me sipërfaqe-bruto të gabaritit të jashtëm të objektit.

27.4. Lartësia e taksës sipas kësaj dispozite, llogaritet për të gjitha objektet banesore, objektet ekonomike të ndërtuara me material të fortë dhe sistem montazh, ku kërkohet leja ndërtimore.

27.5 Caktimi i lartësisë së taksë ndërtimore bëhet sipas tabelës nr. 3.

27.6 Tarifa e lejes ndërtimore aplikohet për ndërtimet të hapësirave të banimit, ndërtimi i ri, mbindërtim, aneks ndërtim dhe rikonstruktimin e objekteve.

27.8 Tarifa për lejen ndërtimore për lokale afariste të ndërtimit të fortë dhe ndërtimit montazhe, për hapësira bruto llogaritet sipas tabelës nr.4.

**Tabela Nr.3**

Nr.	Ndërtimi i objekteve për banim dhe afarizëm	Shuma/€
1	Taksa administrative ndërtimore për kategorinë e I-rë në sip. bruto m <sup>2</sup>	1.90 €
2	Taksa administrative ndërtimore për kategorinë e II-të në sip. bruto m <sup>2</sup>	4.70 €
3	Taksa e densitetit të infrastrukturës për të gjitha kategoritë në sip. bruto në m <sup>2</sup>	4.00 €
4	Taksa për Rrënim në sip. bruto në m <sup>2</sup>	0.70 €

**Tabela Nr.4**

Nr.	Hapësirat afariste	Shuma/€
1	Taksa ndërtimore në sipërfaqen bruto në m <sup>2</sup> (ekonomike, ndërtimet e forta, ndërtimet montazhe, ndërtimet e përkohshme)	6.80 €
2	Taksa ndërtimore në sipërfaqen bruto në m <sup>2</sup> (fabrikat për prodhim)	0.30 €
2	Taksa për Shtalla në sip. bruto në m <sup>2</sup>	0.30 €
3	Taksa për Silose në sip. bruto në m <sup>3</sup>	0.30 €

**Neni 29 pika 4 riformulohet si në vijim;** Objektet, banesat dhe lokalet afariste në pronësi të komunës i jepen me qira të gjithë personave fizik dhe juridik, banesat e komunës mund të ipen me qira edhe për raste sociale.

**Neni 34 pika 22 ndryshohet në;**

22. Lartësia e qirasë mujore për shfrytëzimin e banesave në pronësi të komunës të cilat kanë karakter social përcaktohet sipas Ligji nr. 03/I-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, neni 9 Përcaktimi i qirasë;

22.1 Kuvendi komunal çdo vit aprovon shumën e qirasë vjetore për banesat me qira e cila përcaktohet sipas formulës:

$$Q_{jm} = V_b \times 0.04$$

ku:

12 Q<sub>jm</sub> - Qiraja jo profitabile mujore

22.2. Qiraja e grumbulluar nga banesat shfrytëzohet për mbulimin e kostos së administrimit, mirëmbajtjes, amortizimit, riparimet e rregullta dhe investuese të objektit të banimit.

22.3. Qiramarrësi, përveç qirasë, paguan edhe të gjitha shpenzimet tjera që lidhen me shfrytëzimin e zakonshëm të banesës.

22.4. Vlera vjetore e qirasë nuk duhet të jetë më e madhe se katër përqind (4%) e kostos së ndërtimit të banesës së shtetit, për ndërtim të ri, apo katër përqind (4 %) e vlerës së banesës në treg.

22.5. Kur banesat e programeve të veçanta financohen nga burime tjera të përcaktuara me nën-paragrafin 1.3 të nenit 15 dhe me nën-paragrafin 1.3 të nenit 19 të këtij ligji vlera e qirasë e shprehur me Euro/m<sup>2</sup>, përcaktohet për çdo rast specifik në bashkëpunim në mes subjekteve që financojnë dhe komunës ku zbatohet projekti dhe miratohet me vendim të Kuvendit Komunal.

REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO  
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

DIREKTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA

Datë / Irfazje / Date / Dana: 02.12.2022

Nr. Org. / Org. jed: 01    Nr. Prot. / Br. Prot.: 148    Nr. Faqes / Br. Strana: 1

Ferizaj - Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO  
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

**KUVENDI I KOMUNES  
 SKUPSTINA OPŠTINE  
 MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.148  
 Data:30.11.2022**

Në bazë të nenit 58 pika 1.h të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 51 pika 2.9, të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 i datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.11.2022 miratoi këtë:

**VENDIM**

**PËR APROVIMIN E PROJEKT RREGULLORËS TË KOMUNËS PËR TAKSA**

**I**

**MIRATOHET:** Propozimi i Kryetarit të Komunës së Ferizajt me Nr:293/22 i datës 15.11.2022 për Aprovimin e Projekt Rregullorës të Komunës për Taksë.

**II**

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e aktiviteteve të cilat i nënshtrohen taksës së komunës në Komunën e Ferizajt, lartësinë e taksave përcaktimin e kategorive të lira nga kjo taksë dhe përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve kundërvajtëse për shkeljet e dispozitave të kësaj rregullore.

**III**


Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen; Kryetari i Komunës si dhe Drejtoria e Financave.

**IV**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration


Për:	Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajt Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Ferizajt	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Fahrije Tërnavë, Sekretare e Përgjithshme MPB Servet Spahiu, Zv. sekretar i përgjithshëm në MMPHI Fadile Dyla, Sekretare e përgjithshme në MASHT Lulzim Beqiri, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, MD	
Përmes:		
Nga:	Venera Çerkini, Zv. Sekretare e Përgjithshme në MAPL	Datë: 20.12.2022
Zyrtarët përgjegjës:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Nr.43-1084//2
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	<i>[Signature]</i>
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorim të Komunave	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Ferizajt nga Ministri të Linjës -	
Lloji i aktit:	Rregullore i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar Rregulloren Nr. 01-020/08-13129/22, për taksat komunale të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Ferizajt dhe i nënshtruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Ferizajt, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 3, të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministri të Linjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.  
Bashkangjitur raportin nga MPB, MMPHI, MASHT, MD sipas të cilit kërkohet nga Kuvendi i Komunës së Ferizajt.



## RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTIT

### MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Lidhur me Rregulloren për taksat komunale të Kuvendit Komunal Ferizaj duhet të jetë në harmoni me Neni 63 Gjobat, ashtu si na obligon Ligji Nr 04/L-003 për Gjendjes Civile, e ku në këtë rregullore në Nenin 7 pika 7.17 vlera duhet të jete sikur të pika 7.18 dhe pika 7.19.

- Te Neni 7 pika 7.17 vlera e gjobës do të duhej të jetë 50-100 euro.

Ligji Nr 04/L-003 për Gjendjes Civile, Neni 63

#### Neni 63 Gjobat

1. Me gjobë dënohet personi për këto shkelje:

1.1. prej njëzet (20) deri pesëdhjetë (50) Euro kur nuk paraqet lindjen e fëmijës në afatin e paraparë me këtë ligj;

1.2. prej pesëdhjetë (50) deri njëqind (100) Euro kur nuk e lajmëron vdekjen në afatin e caktuar sipas këtij ligji;

### MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURË

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, konstaton:

#### Fusha e ndërtimit

Në nenin 27 të kësaj rregulloreje thuhet: Zbatohet vendimi për përcaktimin e taksës administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifave për rregullimin e infrastrukturës në territorin e qytetit të Ferizajt paraprakisht i miratuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Nga ajo që u tha më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura konstatoi: Komuna e Ferizajt, nuk ka specifikuar se për cilën taksë bëhet fjalë, pasi që nga data 23.12.2019 kur MYPH ka dhënë pëlqimin për këto taksë, Komuna e Ferizajt që nga atëherë nuk ka paraqitur kërkesë në Ministri për miratim të këtyre taksave, edhe pse sipas legjislacionit në fuqi, Ligji NR. 04/L - 110 për Ndërtim dhe UA Nr. 02/2018, komunat janë të obliguara që për çdo vit të dorëzojnë taksën e propozuar vjetore ndërtimore Ministrisë ose njoftimin se është duke i zbatuar taksat e njëjta.

Gjithashtu, Komuna e Ferizajt, duhet të specifikojë që vendimi për përcaktimin e taksës administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifave për rregullimin e infrastrukturës, vlen për gjithë territorin e Komunës së Ferizajt, e jo vetëm për qytetin e Ferizajt, siç shkruan në rregullore.

#### Fusha e Agjencionit kadastral

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë -AKK, analizo "Rregulloren 01 Nr.148 për taksë, miratuar nga KK Ferizaj" me ç rast konstatoi se tarifave të përcaktuara për pikën V. "DREJTORIA PËR PRONË, GJEODEZI DHE KADASTËR" është në pajtim me aktet nënligjore: Udhëzimet Administrative MEA Nr. 09/2020 për Tarifa e Shërbimeve për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës Paluajtshme, MMPPH Nr. 12/2019 për Ndarjen dhe Regjistrimin e Parcelës dhe MMPHI Nr. 11/2019 për Ndarjen e Ndërtesës dhe Pjesës së Ndërtesës.

Mirëpo, kjo rregullore nuk është bazuar dhe nuk ka përcaktuar tarifave të parapara me aktin nënligjor Udhëzim Administrativ (MMPHI) Nr. 05/2021 për Ndryshimin dhe Përfundimin e Udhëzimit Administrativ (MEA) Nr. 09/2020 për Tarifave të Shërbimeve për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës Paluajtshme.

Prandaj, ndryshimet e parapara në këtë akt nënligjor duhet të pasqyrohen edhe me rregullore.

#### Fusha e Banimit

Ligji Nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit, e veçanërisht ne:


- Neni 9 - Përcaktimi i qirasë, ku në paragrafin 1 thuhet se "Kuvendi komunal çdo vit aprovon shumën e qirasë vjetore për banesat me qira e cila përcaktohet sipas formulës;
- Paragrafi 2 - Qiraja e grumbulluar nga banesat shfrytëzohet për mbulimin e kostos së administrimit, mirëmbajtjes, amortizimit, riparimet e rregullta dhe investime të objektit të banimit. Paragrafi 3- Qiramarrësi, përveç qirasë, paguan edhe të gjitha shpenzimet tjera që lidhen me shfrytëzimin e zakonshëm të banesës.
- Paragrafi 4 - Vlera vjetore e qirasë nuk duhet të jetë më e madhe se katër për qind (4%) e kostos së ndërtimit të banesës së shtetit, për ndërtim të ri, apo katër për qind (4%) e vlerës së banesës në treg.
- Paragrafi 5 - Kur banesat e programeve të veçanta financohen nga burime tjera të përcaktuara me nën-paragrafin 1.3 të nenit 15 dhe me nën-paragrafin 1.3 të nenit 19 të këtij ligji vlera e qerasë e shprehur me Euro/m<sup>2</sup>, përcaktohet për çdo rast specifik në bashkëpunim në mes subjekteve që financojnë dhe komunës ku zbatohet projekti dhe miratohet me vendim të Kuvendit Komunal, nuk e ka potencuar rregullimin e përcaktimit të qerasë dhe nuk e ka specifikuar.


Vlerësim:

Rregullorja 01 Nr.148 për taksë, miratuar nga KK Ferizaj, në Kapitullin VIII- Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, Neni 34, të tabela që përshkruan Llojin e shërbimeve, në pikën 22, e përshkruan dhe e saktëson që Lartësia e qirasë mujore për shfrytëzimin e banesave në pronësi të komunës të cilat kanë karakter social është 0.10€ për 1m<sup>2</sup>.

Andaj konsiderojmë që e njëjta nuk është sipas formulës së Ligjit Nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit.





MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT 

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ka pranuar kërkesën për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të komunës së Ferizajt, Rregulloren e Kuvendit të Komunës me nr. 01. Nr. 148 për taksë, e miratuar me datë 30.11.2022.

Gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së Rregullores së lartëkur për pagesat e përcaktuara për fushën e arsimit, konkretisht nenet 38, 39, 40, 41, 42, ju njoftojmë se:

Dispozitat e përcaktuara në nenin 38 paragrafi 34.1, 34.2, 34.3, 34.4, 34.5 janë në përputhje me Rregulloren e MASHTI-t me nr. 01/2017.

Ndërsa, paragrafi 34.6 të të njëjtit nen nuk është i paraparë me legjislacionin e MASHTI-t.

Po ashtu edhe nenet 39, 40, 41 dhe 42 nuk janë të parapara me legjislacionin e MASHTI-t.

MINISTRIA E DREJTËSISË 

Në cilësinë e anëtarit të Komisionit ndërmintor për shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve të komunave që prekin fushat e dy a më shumë ministriye, si përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë, për fushën e përgjegjësisë administrative të Ministrisë së Drejtësisë, që prek këtë Rregullore, ju njoftoj si në vijim lidhur me dy çështje:

Çështja e parë:

Rregullorja në nenin 1 të saj, përcakton si në vijim: *"Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e aktiviteteve të cilat i nënshtrohen taksës komunale të Komunës së Ferizajt (këtu e tutje: "Komuna"), lartësinë e taksave komunale, përcaktimin e kategorive të lirë nga kjo taksë dhe përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve kundërvajtëse për shkeljet e dispozitave të kësaj Rregulloreje."*

Gjatë analizimit dhe shqyrtimit të kësaj Rregulloreje, kemi vërejtur se edhe pse është përcaktuar në nenin 1 të saj *"Qëllimi"*, se kjo Rregullore ka për qëllim *"(...) përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve kundërvajtëse (...)"*, askund në Rregullore nuk përcaktohet ndonjë kundërvajtje apo sanksion kundërvajtës.

Andaj, në këtë format të Rregullores, pjesa integrale hijezuar më lartë në nenin 1; propozojmë dhe që të fshihet sepse Rregullorja në përmbajtjen e saj nuk përcakton asnjë veprim apo mosveprim që paraqet kundërvajtje apo ndonjë sanksion kundërvajtës sipas legjislacionit në fuqi.

Çështja e dytë:

Nëse Komuna e Ferizajt eventualisht do të përcaktojë kundërvajtje apo sanksioneve kundërvajtëse në Rregullore, siç është përcaktuar në nenin 1 të saj, atëherë duhet që ti ketë parasysh rekomandimet tona të mëposhtme, në mënyrë që kundërvajtjet dhe sanksionet kundërvajtëse, të jenë në përputhje të plotë me legjislacionin përkatës në fuqi për kundërvajtjet.

Në këtë drejtim, neni 7 i Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtjet, përcakton si në vijim: *"Kundërvajtjet dhe sanksionet për kundërvajtje mund të përcaktohen me ligj dhe me akte (rregullore komunale) të Kuvendit të Komunës."*

Duke pas për bazë këtë, meqenëse Ligji për Kundërvajtje na jep një autorizim ligjor të tillë është e nevojshme që brenda kësaj Rregullore të përcaktohen disa çështje, si në vijim:

- Cilat veprime apo mos veprime te personave fizik, personave juridik, personave pergjegjes te personave juridik apo personave fizik qe ushtrojne biznes individual, do te perbejne kundervajtje (sipas nenit 8 te Ligjit per Kundervajtjet);
- Sa do te jetë sanksioni kundervajtës me gjobë për shkeljen e dispozitave konkrete të Rregullores (është më se e nevojshme që të përcaktohet limitet e sanksionit kundervajtës me gjobë sipas nenit 29, parag. 4 dhe 5 të Ligjit për Kundervajtjet);
- Kush do të zhvillojë procedurën kundervajtëse, gjykaça apo organi kundervajtës (sipas nenit 55 apo nenit 56 të Ligjit për Kundervajtjet);
- Çështje të tjera të zhvillimit të procedurës kundervajtëse që kanë të bëjnë me shkallëshmërinë sipas nenit 60 të Ligjit për Kundervajtje, pagesën e gjobës ndëshkimore sipas nenit 30 të Ligjit për Kundervajtje, etj.

Pra, në një Rregullore ku parashihen kundervajtje apo sanksione kundervajtëse është e nevojshme që të përcaktohet një kapitull i veçantë i dispozitave ndëshkimore dhe të adresohen çështjet e ngritura më lartë.

Ministria e Drejtësisë mbetet e përkushtuar që t'ju ofrojë sqarime të tjera shtesë përkritazi me këto çështje.

E/I nderuar,

Nga MAPL kemi pranuar kërkesën përmes emailit zyrtar me datën 12.12.2022 për shqyrtimin e ligjshmërisë të Rregullores nr.01.148 datë 30.11.2022 për Taksën të Kuvendit të Komunës së Ferizajt”.

Kërkesa për shqyrtim të ligjshmërisë të rregullores së lartëeëkur si qështje kryesore dhe objektive ka të bëjë me Taksën, gjegjësisht me financa.

Andaj, ju dërkoim, Rregullores nr.01.148 datë 30.11.2022 për Taksën të Kuvendit të Komunës së Ferizajt dhe Kërkesën e MAPL-së , në kuptimin e neit 75 të Ligjit nr. 05/L - 031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative për shkak të jòkompetencës.

Me respekt.

**From:** Florije Boshnjaku  
**Sent:** Monday, December 12, 2022 2:44 PM  
**To:** Zymer Avdullahu  
**Cc:** Servet Spahiu; Ajshe Ejupi; Shqipe Hyseni; Gëzim Sahiti  
**Subject:** FW: Përshtendetje

I nderuar

Nga MAPL-ja kemi pranuar kërkesën për vlerësim të ligjshmërisë të *Rregulloren për taksën të Komunës të Ferizajt*, mundësisht ta shqyrtoni dhe të vepronin në kompetencë.

Ju faleminderit për bashkëpunim dhe mirëkuptim

Me respekt;

Florije Boshnjaku  
Drejtoe e Departamentit Ligjor  
MMPHI  
Adresa: Sheshi “Nëna Terezë”, ish ndërtesa e Gërmisë  
Tel: 038 200 28 521  
Email: [florije.boshnjaku@rks-gov.net](mailto:florije.boshnjaku@rks-gov.net)

**From:** Gëzim Sahiti  
**Sent:** Monday, December 12, 2022 12:27 PM  
**To:** Krenare Sfishta; Florije Boshnjaku; Selvie Çeku; Elhame Shabani; Aferdita Syle Hoxha; Sabrie Rama; Kadrije Sherifi; Isah Rudaku  
**Cc:** Xhevat Tafa  
**Subject:** Përshtendetje

Të nderuar/a

Po ju rikujtoj edhe njëherë qe keni pranuar me 06.12.2022 përmes Shkrimitores së MAPL-së për vlerësim të ligjshmërisë të *Rregulloren për taksën të Komunës të Ferizajt* andaj pres nga ana e juaj që brenda afatit ligjor të mi dërgoni vlerësimet nga Ministritë tuaja ose nëse ka vonës të me njoftoni me qellim që ta njoftomi komunën për vonesa në vlerësim.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj!

Me respekt

Gëzim Sahiti

Zyrtar i lartë për Monitorim të Komunave  
Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave  
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

☎ 038/200-35-574 Mob. +383 44 393-313

✉ [gëzim.sahiti@rks-gov.net](mailto:gëzim.sahiti@rks-gov.net)

Adresa: Ndërtesa e Qeverisë (ish-Rilindja), kati XI zyra Nr.1117

D

Rregullorja 01 Nr.148 për Taksa e miratuar nga Kuvendi i Komunës Ferizaj dhe e nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Ferizaj, në nenet 21, 23 dhe 24 janë të përfshira taksat për fushën e bujqësisë dhe konfirmon se janë në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

#### Arsyetim

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, taksat për kompensim të ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore i ka të përcaktuara në nenin 14 të Udhëzimit Administrativ Nr.41/2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, taksat për shërbimet profesionale për prerje të pyjeve private i ka të përcaktuara në nenin 6 të Udhëzimit Administrativ MA-NR.12/2005 për caktimin e çmimeve – taksave për shfrytëzimin e produkteve pyjore-drunore, jo drunore dhe shërbime profesionale teknike, të datës 16 maj 2005, dhe taksat për shfrytëzimin e kullotave i ka të përcaktuara në nenin 4 të Udhëzimit Administrativ MA-NR.09/2007 për shfrytëzimin e kullotave të datës 30.03.2007.

Ministria përgjegjëse për bujqësi, konfirmon se të gjitha taksat e përcaktuara në Rregulloren 01 Nr.148 për Taksa të datës 05.12.2022 për fushën e bujqësisë janë në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, mbetet në dispozicion të komunës dhe MAPL-së, për çlarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

u

Inderuar z. Sahiti,

Ministria e Drejtësisë, ka pranuar më datë 6 dhjetor 2022, Rregulloren nr. 01.Nr.148 për taksë të Komunës së Ferizajt, të miratuar më datë 30.11.2022 dhe të parashtruar në MAPL më datë 05.11.2022 (më tej: Rregullorja).

Në cilësinë e anëtarit të Komisionit ndërmintor për shqyrtimin e ligjshmerisë së akteve të komunave që prekin fushat e dy a më shumë ministrive, si përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë, për fushën e përgjegjësive administrative të Ministrisë së Drejtësisë, që prek këtë Rregullore, ju njoftoj si në vijim lidhur me dy çështje:

#### Çështja e parë:

Rregullorja në nenin 1 të saj, përcakton si në vijim: "Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e aktioiteve të cilat i nënshtrohen taksës komunale të Komunës së Ferizajt (këtu s' tujtje: "Komuna"), lartësinë e taksave komunale, përcaktimin e kategorive të liruara nga kjo taksë dhe përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve kundërvajtëse për shkeljet e dispozitave të kësaj Rregulloreje."

Gjatë analizimit dhe shqyrtimit të kësaj Rregulloreje, kemi vërejtur se edhe pse është përcaktuar në nenin 1 të saj "Qëllimi", se kjo Rregullore ka për qëllim "(...) përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve kundërvajtëse (...)", askund në Rregullore nuk përcaktohet ndonjë kundërvajtje apo sanksion kundërvajtës.

Andaj, në këtë format të Rregullores, pjesa integrale hijezuar më lartë në nenin 1, propozojmë dhe që të fshihet sepse Rregullorja në përmbajtjen e saj nuk përcakton asnjë veprim apo mosveprim që paraqet kundërvajtje apo ndonjë sanksion kundërvajtës sipas legjislacionit në fuqi.

#### Çështja e dytë:

Nëse Komuna e Ferizajt eventualisht do të përcaktojë kundërvajtje apo sanksioneve kundërvajtëse në Rregullore, siç është përcaktuar në nenin 1 të saj, atëherë duhet që ti ketë parasysh rekomandimet tona të mëposhtme, në mënyrë që kundërvajtjet dhe sanksionet kundërvajtëse, të jenë në përputhje të plotë me legjislacionin përkatës në fuqi për kundërvajtjet.

Në këtë drejtim, neni 7 i Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtjet, përcakton si në vijim: "Kundërvajtjet dhe sanksionet për kundërvajtje mund të përcaktohen me ligj dhe me akte (rregullore komunale) të Kuvendit të Komunës."

Duke pas për bazë këtë, meqenëse Ligji për Kundërvajtje na jep një autorizim ligjor të tillë është e nevojshme që brenda kësaj Rregullore të përcaktohen disa çështje, si në vijim:

- Cilat veprime apo mos veprime të personave fizik, personave juridik, personave përgjegjës të personave juridik apo personave fizik që ushtrojnë biznes individual, do të përbëjnë kundërvajtje (sipas nenit 8 të Ligjit për Kundërvajtjet);
- Sa do të jetë sanksioni kundërvajtës me gjobë për shkeljen e dispozitave konkrete të Rregullores (është më se e nevojshme që të përcaktohet limitet e sanksionit kundërvajtës me gjobë sipas nenit 29, paragraf 4 dhe 5 të Ligjit për Kundërvajtjet);
- Kush do të zhvillojë procedurën kundërvajtëse, gjykata apo organin kundërvajtës (sipas nenit 55 apo nenit 56 të Ligjit për Kundërvajtjet);

Çështje të tjera të zhvillimit të procedurës kundërvajtëse që kanë të bëjnë me shkallëshmërinë sipas nenit 60 të Ligjit për Kundërvajtje, pagesën e gjobës ndëshkimore sipas nenit 30 të Ligjit për Kundërvajtje, etj.

Pra, në një Rregullore ku parashihen kundërvajtje apo sanksione kundërvajtëse është e nevojshme që të përcaktohet një kapitull i veçantë i dispozitave ndëshkimore dhe të adresohen çështjet e ngritura më lartë.

Ministria e Drejtësisë mbetet e përkushtuar që t'ju ofrojë sqarime të tjera shtesë përkitazi me këto çështje.

Ju faleminderit për mirëkuptimin tuaj!



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

08/12/2022  
08.12.2022  
dy

Për:	Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizaj. Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Ferizaj.
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Venera Çerkini, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, MAPL-së. Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL-së.
Përmes:	Hajrulla Çeku, Ministër i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Feim Hoxha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
Nga:	Fatmir Kastrati, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor në MKRS-së. <span style="float: right;">Datë: 07.12.2022</span>
Zyrtarët përgjegjës:	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Shqipe Kusari, Zyrtari hartues i vlerësimit. <i>[Signature]</i>
Lënda:	Kërkesë për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Ferizaj.
Lloji i aktit.	<input type="checkbox"/> Statut i komunës <input type="checkbox"/> Rregullore <input type="checkbox"/> Rregullore e Kuvendit të Komunës <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> Akt tjetër i komunës:

I nderuar Kryetar/e,  
I nderuar Kryesues/e,  
Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Rregullore (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:



Emri i aktit (vendim, rregullore, statut) Rregullore 01.Nr.143, për taksë.

I miratuar më datë: 30.11.2022

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 05.11.2022

I dërguar për shqyrtim në MKRS-së më datë:  
06.12.2022

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës nuk është në kompetencë të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit mbetet në dispozicion të Komunës së Rahovecit dhe MAPL-së, për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm.

Rregullorja 01.Nr.148, për taksë, miratuar nga KK Ferizaj

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, konstaton:

#### Fusha e ndërtimit

Në nenin 27 të kësaj rregulloreje thuhet: Zbatohet vendimi për përcaktimin e taksës administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifave për rregullimin e infrastrukturës në territorin e qytetit të Ferizajt paraprakisht i miratuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Nga ajo që u tina më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë konstatoi: Komuna e Ferizajt, nuk ka specifikuar se për cilën taksë bëhet fjalë, pasi që nga data 23.12.2019 kur MMPH ka dhënë pëlqimin për këtë taksë, Komuna e Ferizajt që nga atëherë nuk ka paraqitur kërkesë në Ministri për miratim të këtyre taksave, edhe pse sipas legjislacionit në fuqi, Ligji NR. 04/L - 110 për Ndërtim dhe UA Nr. 02/2018, komunat janë të obliguara që për çdo vit të dorëzojnë taksën e propozuar vjetore ndërtimore Ministrisë ose njoftimin se është duke i zbatuar taksat e njëjta.

Gjithashtu, Komuna e Ferizajt, duhet të specifikojë që vendimi për përcaktimin e taksës administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifave për rregullimin e infrastrukturës, vlen për gjithë territorin e Komunës së Ferizajt, e jo vetëm për qytetin e Ferizajt, siç shkruan në rregullore.

#### Fusha e Agjencinë kadastral

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë -AKK, analizoi "Rregulloren 01 Nr.148 për taksë, miratuar nga KK Ferizaj" me ç'rast konstatoi se tarifave përcaktuara për pikën V. "DREJTORIA PËR PRONË, GJEODEZI DHE KADASTËR" është në pajtim me aktet nënligjore: Udhëzimet Administrative MEA Nr. 09/2020 për Tarifa e Shërbimeve për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës Paluajtshme, MMPPH Nr. 12/2019 për Ndarjen dhe Regjistrimin e Parcelës dhe MMPH Nr. 11/2019 për Ndarjen e Ndërtesës dhe Pjesës së Ndërtesës.

Mirëpo, kjo rregullore nuk është bazuar dhe nuk ka përcaktuar tarifave e parapara me aktin nënligjor Udhëzim Administrativ (MMPH) Nr. 05/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MEA) Nr. 09/2020 për Tarifat e Shërbimeve për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës Paluajtshme.

Prandaj, ndryshimet e parapara në këtë akt nënligjor duhet të pasqyrohen edhe me rregullore.

#### Fusha e Banimit

Ligji Nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit, e veçanërisht në:

- Neni 9 - Përcaktimi i qirasë, ku në paragrafin 1 thuhet se "Kuvendi komunal çdo vit aprovon shumën e qirasë vjetore për banesat me qira e cila përcaktohet sipas formulës:
- Paragrafi 2 - Qiraja e grumbulluar nga banesat shfrytëzohet për mbulimin e kostos së administrimit, mirëmbajtjes, amortizimit, riparimet e rregullta dhe investuese të objektit të banimit. Paragrafi 3- Qiramarrësi, përveç qirasë, paguan edhe të gjitha shpenzimet tjera që lidhen me shfrytëzimin e zakonshëm të banesës.
- Paragrafi 4 - Vlera vjetore e qirasë nuk duhet të jetë më e madhe se katër për qind (4%) e kostos së ndërtimit të banesës së shtetit, për ndërtim të ri, apo katër për qind (4 %) e vlerës së banesës në treg.
- Paragrafi 5 - Kur banesat e programeve të veçanta financohen nga burime tjera të përcaktuara me nën-paragrafin 1.3 të nenit 15 dhe me nën-paragrafin 1.3 të nenit 19 të këtij ligji vlera e qirasë e shprehur me Euro/m<sup>2</sup>, përcaktohet për çdo rast specifik në bashkëpunim në mes subjekteve që financojnë dhe komunës ku zbatohet projekti dhe miratohet me vendim të Kuvendit Komunal, nuk e ka potencuar rregullimin e përcaktimit të qirasë dhe nuk e ka specifikuar.

Vlerësim:

*Rregullorja 01 Nr.148 për taksë, miratuar nga KK Ferizaj, në Kapitullin VIII- Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, Neni 34, të tabela që përshkruan Elojin e shërbimeve, në piken 22, e përshkruan dhe e saktëson që Lartësia e qirasë mujore për shfrytëzimin e banesave në pronësi të komunës të cilat kanë karakter social është 0.10€ për 1m<sup>2</sup>. Andaj konsiderojmë që e njëjta nuk është sipas formulës së Ligjit Nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit.*

Të nderuar,

Gjeni si më poshtë përgjigjen nga ARC-ja respektivisht nga z.j. Merita Visoka, lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë për Rregulloren për Taksat Komunale të Komunës së Ferizajt.

Me respekt,

*Gjejrane Gashi*  
Zyrtare e Lartë Ligjore  
Departamenti Ligjor-- Ministria e Punëve të Brendshme  
tel: 033-200-19-515--- mob: 044-135-022

**From:** Merita Visoka  
**Sent:** 07 December 2022 14:05  
**To:** Gjejrane Gashi <[Gjejrane.Gashi@rks-gov.net](mailto:Gjejrane.Gashi@rks-gov.net)>  
**Cc:** Krenare Sfishta <[Krenare.Sfishta@rks-gov.net](mailto:Krenare.Sfishta@rks-gov.net)>; Sebahate Bardhi <[Sebahate.Bardhi@rks-gov.net](mailto:Sebahate.Bardhi@rks-gov.net)>; Erdon Arifaj <[Erdon.Arifaj@rks-gov.net](mailto:Erdon.Arifaj@rks-gov.net)>  
**Subject:** FW: Kërkesë për vlerësim të ligjshmërisë aktit të Komunes së Ferizajt- Shkresë përcjellëse nga MAPL

E nderuar,

Lidhur me Rregulloren për taksat komunale të Kuvendit Komunal Ferizaj duhet të jetë në harmoni me Neni 63 Gjobat, ashtu si na obligon Ligji Nr 04/L -003 për Gjendjes Civile, e ku në këtë rregullore nuk e vura re, shiqo Neni 7 pika 7.17 vlera duhet të jete sikur të pika 7.18 dhe pika 7.19.

Përcaktimi i tarifave për lëshimin e dokumenteve të gjendjes civile është kompetencë e KK dhe kjo nuk interferon në kompetencat e ARC.

P.S. Propozojmë që KK të kenë një format të rregulloreve dhe të unifikohen taksat për lëshimin e dokumenteve të gjendjes civile, për aq sa është e mundur.

P.S. Neni 63 Gjobat

1. Me gjobë dënohet personi për këto shkelje:

1.1. prej njëzet (20) deri pesëdhjetë (50) Euro kur nuk paraqet lindjen e fëmijës në afatin e paraparë me këtë ligj;

1.2. prej pesëdhjetë (50) deri njëqind (100) Euro kur nuk e lajmëron vdekjen në afatin e caktuar sipas këtij ligji;

Me respekt,  
Merita Visoka

**From:** Sebahate Bardhi  
**Sent:** 06 December 2022 3:29 PM

**To:** Merita Visoka <[merita.visoka@rks-gov.net](mailto:merita.visoka@rks-gov.net)>

**Subject:** FW: Kërkesë për vlerësim të ligjshmërisë aktit të Komunes së Ferizajt- Shkresë përcjellëse nga MAPL

Merita, shih kërkesën dhe te lutem kthe përgjigje.

Me respekt,

---

Sebahate Bardhi

Udhëheqëse e Sektorit të Verifikimit /Drejtorati i Gjendjes Civile  
Agjencia e Regjistrimit Civil  
Ministria e Punëve të Brendshme  
Centrix: 038 200 19 199  
Mob:+ 383(0) 44 636 742

From: Gjejrane Gashi

Sent: 06 December 2022 3:14 PM

To: Sebahate Bardhi <Sebahate.Bardhi@rks-gov.net>; Liridon Neziri <Liridon.Neziri@rks-gov.net>

Cc: Naim Shala <Naim.Shala@rks-gov.net>; Krenare Sfishta <Krenare.Sfishta@rks-gov.net>; Erdon Arifaj <Erdon.Arifaj@rks-gov.net>; Valon Krasniqi <Valon.Krasniqi@rks-gov.net>; Safete n. Makolli <Safete.n.makolli@rks-gov.net>

Subject: FW: Kërkesë për vlerësim të ligjmerisë aktit të Komunes së Ferizajt- Shkresë përcjellëse nga MAPL

Të nderuar,

Referuar kërkesës nga MAPL-ja (shih si më poshtë) kërkojë nga ana juaj që të shqyrtoni aktin e Komunes së Ferizajt pra, Rregulloren për Taksa Komunale dhe të ktheni përgjigje lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë sa i përket fushës që ju e mbulonit e që lidhet me fushëveprimtarin e MPB-së, me qëllim që të njëjtin në emër të MPB-së ta përcjellim në MAPL-ja.

Për atë që ne e kemi trajtuar në DL, ka të bëjë me ARC-në dhe DSHAM/DSH konkretisht në nenin 7,

Bashkangjitur gjeni Rregulloren e Komunes së Ferizajt.

Me respekt,

*Gjejrane Gashi*

*Zyrtare e Lartë Ligjore*

*Departamenti Ligjor-- Ministria e Punëve të Brendshme  
tel: 038-200-19-515--- mob: 044-135-022*

From: Adelina Krasniqi

Sent: 06 December 2022 14:43

To: Naim Shala <Naim.Shala@rks-gov.net>

Cc: Fahrije Ternava <Fahrije.Ternava@rks-gov.net>; Riga Buja <riga.buja@rks-gov.net>; Esat Abiti <esat.abiti@rks-gov.net>; Besarta Berisha <besarta.berisha@rks-gov.net>; Krenare Sfishta <Krenare.Sfishta@rks-gov.net>; Gjejrane Gashi <Gjejrane.Gashi@rks-gov.net>


Subject: FW: Shkresë përcjellëse nga MAPL

I nderuar,

Ju lutem ta shqyrtoni kërkesën nga MAPL.

Me respekt,

Adelina Krasniqi- Ibrahimi  
Asistente Administrative e Sekretares së Përgjithshme  
Ministria e Punëve të Brendshme  
Tel: 038-200-19-005  
E-mail: [adelina.krasniqi@ks-gov.net](mailto:adelina.krasniqi@ks-gov.net)



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë  
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine  
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Për:	Agim Aliu -Kryetar i Komunës së Ferizajt Xhavit Zariqi-Kryesues i Kuvendit të Komunës së Ferizajt
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunën e Ferizajt
Përmes:	Rexhep Bllaca, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Nga:	Selvie Çeku, Zv. Udhëheqëse e Departamentit Ligjor në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Lënda :	Shqyrtimi i ligjshmërisë së aktit të Kuvendit të Komunës së Ferizajt
Lloji i aktit:	Rregullore 01.Nr. 148 për taksat

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në mbështetje të nenit 81.4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK)nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, MAPL, me datë: 05.11.2022 ka pranuar për vlerësim të ligjshmërisë Rregullore 01.Nr. 148 për taksat në Komunën së Ferizajt datë 30.11.2022 të nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Ferizajt.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) ka bërë shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe :

## KONFIRMON

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës, konfirmon se akti i komunës së Ferizajt nuk është në kundërshtim me dispozitat e Akteve Ligjore në fuqi të miratnara nga kjo Ministri.

### Arsyetim

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës për shqyrtimin e Rregullores 01.Nr. 148 për taksat, protokollin -VI-43-108/1 datë 05.12.2022 të komunës së Ferizajt : vlerëson se rregullorja në fjalë nuk është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi e as me ndonjë akt nënligjor tashmë të miratuar.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë mbetet në dispozicion të MAPL-së dhe Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë.

Me respekt,